




<b>REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT</b> <b>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	01-1020/15
Dep.	07.04.2015
Nr. I faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.04.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I, Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-02-225-15 për z.Zair Imeri – Zyrtar kryesor financiar në Ndërrmarrjen publike “Infrakos” sh.a. dhe ish-Anëtar i përkohshëm i Bordit të Postës së Kosovës, për shkak se z.Imeri, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit, ka dhënë dorëheqje nga funksioni i Anëtarit të përkohshëm të Bordit të Postës së Kosovës.**

**Tani z.Imeri ushtron vetëm funksionin; Zyrtar kryesor financiar në Ndërrmarrjen publike “Infrakos” sh.a.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-225-15, për Zyrtarin e lartë, z. Zair Imeri – Zyrtar kryesor Financiar në Ndërrmarrjen publike “Trainkos” sh.a. dhe njëkohësisht Anëtar i përkohshëm i Bordit të Postës së Kosovës, eshtë trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z. Imeri fillimisht eshtë njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./DPK-01-289/15), pas të cilës ai eshtë kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit (AKK), me ç ‘rast eshtë njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, ndërsa ai ka ofruar sqarimet e nevojshme për situatën, ndërkohe qe ato i ka dërguar edhe me shkrim (DPK/DPKI – 03-02-513-15).

Zyrtari i lartë Zair Imeri ka sqaruar se eshtë i vetëdijshëm se ushtrimi i këtyre dy funksioneve mund të paraqes konflikt interesit, por në kohën kur ai eshtë emëruar për Anëtar te përkohshëm të Bordit të Postës së Kosovës duke qenë njëkohësisht edhe Zyrtar kryesor financiar në ndërrmarrjen

publike "Trainkos", është emëruar vetëm si anëtar i përkohshëm duke mos e ditur se sa do të zgjas ushtrimi i këtij funksioni, sepse është emëruar vetëm për një fazë tranzitore dhe pa konkurs, por me Vendim të Kryeministrat (Vendim Nr.14/67 i Qeverisë së Kosovës).

Tash kur me datë 19.01.2015 Zyra e Kryeministrat të Qeverisë së Kosovës ka shpallur Konkurs për Drejtor të Bordeve të Ndërmarrjeve publike, z.Imeri ka aplikuar për këtë pozitë. Konkursi është mbyll me 18.02.2015 dhe shumë shpejt, siç thotë z.Imeri, do të bëhen zgjedhjet dhe emërimet. z.Imeri është i vetëdijshëm dhe deklaron se në rast të zgjedhjes së tij, atëherë ai menjëherë do të vendosë se cilën nga këto funksione ta mbajë, sepse në të dy këto funksione, sipas Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit, nëpunësi konsiderohen zyrtar i lartë publik.

Pikërisht sipas Ligjit të referuar me lartë (L.P.K.I. Nr.04/L-051), të kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik, ne nenin 16 paragrafi 1 shprehimisht thuhet:

*"Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhue se në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit".*

Në pajtim me këtë pikë, duke qenë se gjendja ka vazhduar të jetë e njëjtë, Agjencia kundër Korruptionit, zyrtarit të lartë z.Imeri i ka bërë edhe shkresën e dyte-Paralajmëruese (Z.D.01-679-15) me të cilën AKK ka konstatuar konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik duke qenë Zyrtar kryesor Financiar në Ndërmarrjen publike "Trainkos" sh.a. dhe njëkohësisht Anëtar i përkohshëm i Bordit të Postës së Kosovës. AKK me këtë shkresë i ka dhënë mundësinë zyrtarit Imeri që në afatin e caktuar kohor të bëjë shmangjen nga kjo situatë.

Ndërkohë z.Imeri, me datën 31.03.2015, në Agjencinë kundër Korruption ka sjellë shkresë zyrtare (DPK-DPKI-03-02-963-15) me të cilën ai i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrat, Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Drejtorit të Njësisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike dhe Drejtorit të Agjencisë kundër Korruption, me të cilën ai ka deklaruar dorëheqjen e tij nga pozita e Anëtarit të Bordit të drejtorëve të Postës së Kosovës sh.a.

Tani z.Imeri ushtron vetëm funksionin; Zyrtar kryesor financiar në Ndërrmarrjen publike "Infrakos" sh.a.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

/ Hasan Preteni

